



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 144/4 Prot.

Tiranë, më 5/6/2013

REKOMANDIM

Nr. 08 datë 05/06 2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Ministria e Drejtësisë" Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrin nr. 44 datë 27/02/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Ministria e Drejtësisë" Tiranë. Ky kontroll administrativ u ushtrua pas kontrolleve administrative të kryera në disa Gjykata të Rretheve Gjyqësore dhe Apeleve në Shqipëri, lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në publikimin e vendimeve gjyqësore në portalin www.gjykata.gov.al. Kontrolluesi "Ministria e Drejtësisë" u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli administrativ.

Objekti i kontrollit administrativ ishte:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në publikimin e vendimeve gjyqësore nga kontrolluesi "Ministria Drejtësisë", në portalin www.gjykata.gov.al, bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 "Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor", në lidhje me:
 - Qëllimin, Proporcionalitetin dhe Përshtatshmërinë.
 - Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
 - Ruajtja e konfidencialitetit (neni 28)
 - Veprimtaritë e përpunuesve në lidhje me publikimin.
- Përdorimi i sistemit ICMIS (sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore).
 - Raporti i Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatave në përdorimin e këtij sistemi.
 - Qëllimi, Proporcionaliteti dhe Përshtatshmëria.
 - Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
 - Ruajtja e konfidencialitetit (neni 28).
 - Veprimtaritë e përpunuesve në lidhje me procesin;

Grupi i kontrollit administrativ:

- U njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin që kontrolluesi “Ministria e Drejtësisë” vuri në dispozicion të grupit të kontrollit administrativ.
- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësues të zyrave dhe departamenteve të këtij kontrolluesi.
- Inspektoi ambientet, zyrat e punës, të këtij kontrolluesi.
- Administroi me cilësi dhe provës në funksion të kontrollit administrativ dokumenta të ndryshme që lidhen me objektin e këtij kontrolli administrativ.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit, krijuan kushtet për zhvillimin e kontrollit, u treguan bashkëpunues në të gjitha fazat e ushtrimit të kontrollit administrativ, si dhe vendosen në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentet shkresore të kërkuara.

Në kuadër të projektit CARD 2004 në gjykatat Shqiptare është instaluar sistemi (ICMIS/CCMIS). Sistemi ICMIS (sistemi informatik i gjykatave për menaxhimin e çështjeve civile dhe penale) është një sistem elektronik që zëvendëson proceset manuale të punës në gjykatat e Shqipërisë nëpërmjet informatizimit të tyre. Në Shtator të vitit 2006 është instaluar versioni i parë i CCMIS (Sistemi Informatik i Gjykatave për Menaxhimin e Çështjeve Civile) në të gjitha gjykatat e shkallëve të para. Ministria e Drejtësisë aktualisht ka bërë të mundur instalimin e sistemit ICMIS (Sistemi Informatik i Gjykatave për Menaxhimin e Çështjeve Civile dhe Penale) pothuaj në të gjitha gjykatat përveç Gjykatave të Rretheve Tiranë, Vlorë, Kukës, Përmet si dhe Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit të Krimeve të Rënda. Aktualisht është në proces dhe po punohet për përshtatshmërinë e sistemit ICMIS në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Sistemi ICMIS funksionon si një sistem i shpërndarë kur çdo gjykatë ka bazën e vet të të dhënave në serverin lokal.

Ministria e Drejtësisë e ka parë të nevojshme që të shtojë funksionalitete të reja në sistemin ICMIS në mënyrë që të rrisë efikasitetin dhe transparencën e tij. Për këtë arsye, në vitin 2011 është kontraktuar një kompani e cila do të realizonte shtimin e disa funksionaliteteve si më poshtë vijon:

- Krijimi i një baze të dhënash qendrore (bashkimi i bazave së të dhënave të të gjitha gjykatave);
- Transferim elektronik i çështjeve në një gjykatë tjetër;
- Unifikim rekordi;
- Moduli për administrimin dhe shfrytëzimin e dosjes elektronike;
- Krijimi i VIEW_ve integrale për të gjitha bazat e të dhënave;
- Statistika globale për të gjitha bazat e të dhënave;
- Zhvillimi i portalit të gjykatave;

Adresa e portalit në web është: www.gjykata.gov.al, bashkimi i databazave ICMIS është kryer për të siguruar një portal unik për të realizuar komunikimin me publikun si dhe komunikimin midis gjykatave në rastet e transferimit elektronik të çështjeve.

Sistemi qendror i cili ka bazat e të dhënave për të gjitha gjykatat ndodhet në ambientet e AKSHI_t. Sistemi i secilës prej gjykatave replikon dhe përditëson bazën e të dhënave qendrore në një orar të caktuar në mënyrë automatike dhe pa patur nevojën e prezencës së specialistëve respektivë. Portali www.gjykata.org (i ndryshuar me vonë në www.gjykata.gov.al) është i asistuar nga ekspertët e misionit Euralius dhe është ndërtuar sipas termave të referencës të tenderuar nga Komisioni Evropian. Mbas marrjes në dorëzim të produktit ICMIS nga Ministria e Drejtësisë, mirëmbajtja e mëvonshme e sistemit ICMIS përfshiu edhe mirëmbajtjen e portalit www.gjykata.org me financim nga buxheti i shtetit. Në kontratën e vitit 2010 të lidhur për mirëmbajtjen e sistemit ICMIS është përfshirë edhe mirëmbajtja e portalit www.gjykata.org në një pjesë të veçantë të kësaj kontrate.

Në portalin www.gjykata.gov.al, për modulin publik të portalit janë ndërtuar 32 portale përbërës (1 portal kryesor; 1 portal për Gjykatën e Lartë; 7 portale për Gjykatat e Apeleve; 32 portale për Gjykatat e Shkallëve të Para). Nëpërmjet portalit të një gjykate, në mënyrë të lirë mund të merret informacion rreth një çështje duke plotësuar filtrat e kërkimit si: emri i gjyqtarit, emri i palës, mbiemri i palës, numri i çështjes, data e regjistrimit, tipi i çështjes, baza ligjore, numri i vendimit, data e vendimit, informacion i përgjithshëm mbi çështjen, palët ndërgjyqëse, vendimi përfundimtar. Për konfigurimin dhe përmbajtjen e portalit www.gjykata.gov.al, Ministria e Drejtësisë në vazhdimësi ka patur asistencën e "USAID Albania" në kuadër të projektit "Albanian Justice Sector Strengthening Project (JuST)". Kontrolluesi Ministria e Drejtësisë ka lidhur kontrata me palë të treta, për zhvillimin e sistemit ICMIS si dhe shërbimeve teknike të nevojshme. Në këto kontrata janë të përcaktuara qartë "Objektivi i kontratës" si dhe detyrat që duhen realizuar për arritjen e këtij objekti.

Gjatë kontrollit administrativ është kërkuar kontakt me përfaqësues të projektit Euralius për të marrë një informacion të plotë lidhur me funksionimin e portalit, si dhe politikën e projektit në aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale. Në mungesë të realizimit të takimit, është kërkuar informacion me shkrim përfaqësuesve të projektit Euralius të cilët kanë përcjellë pranë nesh rekomandimin që ata kanë dhënë për Ministrinë e Drejtësisë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në vendimet gjyqësore përpara se ato të publikohen në portal. Rekomandimi i referohet direktivave 95/46 EC, direktivës 2006/123 EC, ligjit 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe udhëzimeve nr. 15, 21 dhe 22 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konstaton se;

Kontrolluesi "Ministria e Drejtësisë" përmes portalit www.gjykata.gov.al realizon publikimin në internet, të vendimeve gjyqësore, që mbartin të dhëna personale të subjekteve që marrin pjesë në këto procese gjyqësore pa marrë masa për bërjen anonime të të dhënave personale, duke shkelur nenin 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" të ndryshuar "Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private" si dhe udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor" kreu IV "Publikimi i të dhënave personale".

Kontrolluesi "Ministria e Drejtësisë" nuk ka një rregullore të veçantë referuar ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, për "Mbrojtjen , përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale".

Kontrolluesi "Ministria e Drejtësisë" në kontratën e lidhur me subjektin që realizon shërbimet teknike për mirëmbajtjen e "Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore" (ICMIC), nuk ka të përfshira rregulla lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, referuar ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar (nenet 27, 28).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor", për të mbrojtur të dhënat personale që mblidhen, përpunohen dhe ruhen gjatë publikimit të vendimeve gjyqësore në portalin www.gjykata.gov.al

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit, Nr. 15, datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor", kreu IV, të merren masa që publikimi i vendimeve gjyqësore në portalin www.gjykata.gov.al të bëhet duke bërë anonime të dhënat personale të subjekteve që marrin pjesë në procese gjyqësore.
2. Vendimet gjyqësore që do të hidhen në portalin www.gjykata.gov.al pas këtij Rekomandimi, të jenë pa të dhëna personale të cilat identifikojnë personat pjesëmarrës në procese gjyqësore.
3. Të ndërtohet një strategji lidhur me anonimizimin e të dhënave personale për vendimet e vjetra të cilat aktualisht ndodhen të publikuar në portal.
4. Të merren masa për implementimin e Rekomandimeve të projektit Euralius lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në vendimet gjyqësore përpara se ato të publikohen në portal.
5. Të hartohet një Rregullore e veçantë referuar ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, për "Mbrojtjen , përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale".
6. Në kontratën e lidhur me subjektin që realizon shërbimet teknike për mirëmbajtjen e "Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore" (ICMIC), të përfshihen rregulla lidhur me mbrojtjen dhe kofidencialitetin e të dhënave personale.
7. Këto detyrime të rëndësishme të realizohen brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh.
8. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
9. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues,veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij,vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

